



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

V E N D I M

Nr. 12, datë 20.03.2015

MBI

FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2015

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Fondi i Kompensimit krijohet bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur dëmet shkaktohen nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i siguruar sipas ligjit nga ndonjë shoqëri sigurimi, nga një mjet motorik i pidentifikuar apo në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi.

Referuar të dhënave në vite, Fondi i Kompensimit ka pësuar rritje të ndjeshme për shkak të aksidenteve të shumta shkaktuara nga mjetet e pasiguruara apo të pidentifikuara, si dhe nga mosarkëtimi i dëmshpërblimit nga personat përgjegjës apo dhe i gjobave të vëna ndaj pronarëve të mjeteve të pasiguruara. Deri në fund të vitit 2013, ka rezultuar se totali i detyrimeve për pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, që i përket periudhës 2001-2013, është në vlerën 1,348,126,732 lekë.

Autoriteti me vendimin e Bordit nr. 17, datë 28.02.2014, “Mbi Fondin e Kompensimit të vitit 2014”, vendosi shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull deri më 31 dhjetor 2013, në vlerën 1,348,126,732 lekë, brenda tre viteve:

Viti 2014 – 430.000.000 lekë;
Viti 2015 – 450.000.000 lekë;
Viti 2016 – 468.126.732 lekë.

Referuar të dhënave lidhur me situatën e Fondit të Kompensimit për vitin 2014, deri më datë **31.12.2014**, shlyerja e detyrimeve për dëmet pezull rezulton në vlerën **451,558,096 lekë**.

Autoriteti në pikën 4, të këtij vendimi përcaktoi se Fondi i Kompensimit për pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, krijohet duke filluar minimalisht nga vlera 20 milionë lekë.

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 525 prot., datë 20.01.2015, ka depozituar në Autoritet vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 01 datë 20.01.2015, me anë të së cilës është propozuar shuma prej 255,000,000 lekë.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Për vitin 2015, shlyerja e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull është në vlerën 450 milionë lekë.
2. Shoqëritë e sigurimit të fillojnë menjëherë pagesat dhe të raportojnë çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës në Autoritet dhe Byronë Shqiptare të Sigurimit për shlyerjen e detyrimeve.
3. Fondi i Kompensimit për vitin 2015, me qëllim pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, krijohet duke filluar minimalisht nga vlera 20 milionë lekë, dhe i shtohet pjesës së pakosumuar të fondit të kompensimit të vitit 2014, e krijuar për këtë qëllim.
4. Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve te shoqëritë e sigurimit, si dhe të bëjë ndarjen e vlerave të detyrimeve të përcaktuar në pikën 1 dhe 3, të këtij vendimi.
5. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI